



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 129

2 gusht

2013

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr. 602, datë 10.7.2013	Për miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e studimit të fizibilitetit për ndërtimin e vendgrumbullimit rajonal e sanitar për qarkun e Vlorës.....	5457
Vendim i KM nr. 604, datë 10.4.2013	Për miratimin e marrëveshjes shtesë të koncesionit “Për disa ndryshime dhe shtesa në kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, operim, transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Titan” sh.p.k. dhe “Osmani” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Bishnica 1” dhe “Bishnica 2””	5461
Vendim i KM nr. 605, datë 24.7.2013	Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Driza 1”	5464
Vendim i KM nr. 606, datë 24.7.2013	Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Viliq”	5464
Vendim i KM nr. 607, datë 24.7.2013	Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Kolosjan”.....	5465
Vendim i KM nr. 608, datë 24.7.2013	Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Kalivar”	5465

Vendim i KM nr. 609, datë 24.7.2013	Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Plepi”	5466
Vendim i KM nr. 612, datë 24.7.2013	Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Zall Xhuxhe”	5466
Vendim i KM nr. 622, datë 24.7.2013	Për miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Gjadër”	5467
Vendim i KM nr. 630, datë 31.7.2013	Për lejimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për kryerjen e procedurave të prokurimit publik për disa projekte të sistemit gjyqësor.....	5467
Udhëzim i MASH nr. 15, datë 12.7.2013	Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare.....	5468
Urdhër i MASH nr. 296, datë 18.7.2013	Për delegim kompetence.....	5472
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) vertetimin e faktit juridik të lindjes dhe të vdekjes së (Aristir Gjeko) Aristidh Gjoka.....	5473
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Artur Daja.....	5473

VENDIM
Nr. 602, datë 10.7.2013

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE KFW FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E STUDIMIT TË FIZIBILITETIT PËR NDËRTIMIN E VENDGRUMBULLIMIT RAJONAL E SANITAR PËR QARKUN E VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e trakteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e studimit të fizibilitetit për ndërtimin e vendgrumbullimit rajonal e sanitar për qarkun e Vlorës, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE FINANCIMI
NDËRMJET KFW, FRANKURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE (MARRËSI)
PËR VLERËN 930.000 EURO
PËR STUDIMIN E FIZIBILITETIT PËR NDËRTIMIN E VENDGRUMBULLIMIT RAJONAL E
SANITAR PËR QARKUN E VLORËS (WB6 – ALB – ENV – 10)

Mbi bazën e marrëveshjes së zbatimit të arritur ndërmjet KfW dhe BERZH (Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim) në këtë datë dhe mbi kërkesën e Marrësit. Marrësi dhe KfW bëhen këtu pjesë në marrëveshjen e financimit në vijim:

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW do t'i japë Marrësit një kontribut financiar deri në 930.000 euro. Ky kontribut financiar nuk është i kthyeshëm përveçse kur përcaktohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Marrësi do ta përdorë kontributin financiar vetëm për të financuar shërbimet e ekspertit në vijim:

Përgatitjen e studimit të fizibilitetit për ndërtimin e vendgrumbullimit rajonal e sanitar për qarkun e Vlorës (shërbimet e ekspertit).

1.3 Marrësi do t'i kryejë kontributet e veta si palë plotësisht dhe në kohën e duhur. Marrësi do t'i japë KfW mbi kërkesën e saj, prova që provojnë masat e marra për këtë qëllim.

1.4 Taksat dhe detyrime të tjera publike që do të përballohen nga Marrësi, si edhe detyrimet mbi importet nuk do të paguhen nga kontributi financiar.



Neni 2 Livrimi

2.1 Marrësi autorizon këtu KfW që të bëjë pagesa të ndërmjetme dhe përfundimtare nga kontributi financiar për Këshilltarin (Konsulentin). Këto pagesa do të bëhen në përputhje me ecurinë e shërbimeve të ekspertit mbi bazën e faturave origjinale që i paraqiten KfW (duke vënë në dijeni Marrësin) dhe në përputhje me kontratat që do të arrihen ndërmjet Marrësit, përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Këshilltarit. Ky autorizim nga Marrësi vlerësohet se është një kërkesë për livrim për të gjitha pagesat e sipërpërmendura.

2.2 Për pagesat e bëra në një monedhë që është e ndryshme nga ajo që është marrë përsipër (monedhë e huaj), KfW do të debitojë Marrësin për një vlerë të tillë në euro, siç ishte shpenzuar nga KfW për blerjen e monedhës (valutës) së huaj, duke përfshirë shpenzimet e papritura.

2.3 KfW nuk do të mbajë përgjegjësi për vonesat e shkaktuara nga institucionet bankare, që bëjnë transferimin në livrimin apo dërgimin e çfarëdo pagese nga KfW. Nëse ndonjë vonesë është shkaktuar nga KfW, përgjegjësia e saj do të kufizohet në pagesën e interesit të grumbulluar.

2.4 KfW do të ketë të drejtën të refuzojë të bëjë livrime pas datës 31 dhjetor 2014.

2.5 Kontratat e këshillimit do të përfshijnë edhe një dispozitë që përcakton se çfarëdo livrimesh, garancish apo pagesash të tilla të kërkueshme dhe çfarëdo pagesash për sigurime do të bëhen për llogari të Marrësit në llogarinë nr. 38 000 000 00 (IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00) në KfW, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF, BLZ 500 204 00), ku KfW do t'i kreditojë këto pagesa në llogari të Marrësit.

Neni 3 Pezullimi i livrimeve dhe ripagesave (kthimeve)

3.1 KfW nuk mund t'i pezullojë livrimet përveçse, kur:

- a) Marrësi nuk arrin të plotësojë detyrimet e tij kundrejt KfW për të bërë pagesat kur duhet;
- b) Janë shkelur detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje;
- c) Marrësi nuk është i aftë (nuk është në gjendje) që të provojë se shumatat e livruara janë përdorur të gjitha për qëllimin e përcaktuar; ose
- d) Dalin rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë apo vënë seriozisht në rrezik zbatimin e qëllimit të shërbimeve të ekspertit;
- e) Kontrata e këshillimit (konsulencës) për të arritur ndërmjet Marrësit, përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Këshilltarit (Konsulentit) është shkelur, anuluar apo përfunduar.

3.2 KfW do të ketë të drejtë të kërkojë kthimin e menjëhershëm të kontributit financiar, nëse ka ndodhur cilado nga situatat e përcaktuara në nenin 3.1 b) dhe c) dhe nuk është shmangur brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW, periudhë, e cila gjithsesi do të jetë të paktën 30 ditë. Në rastin e parashikuar në nenin 3.1 c) kthimi do të kufizohet në ato shumata për të cilat Marrësi nuk është në gjendje të provojë se janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

Neni 4 Kostot dhe detyrimet publike

Marrësi do të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrime të tjera publike që krijohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë në lidhje me arritjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, si dhe kostot e transfertave dhe konvertimeve, që dalin në lidhje me livrimin e kontributit financiar.

Neni 5

Deklaratat kontraktore dhe fuqia e përfaqësimit

5.1 Ministri i Financës dhe ata persona që përcaktohen nga ai ose ajo për te KfW të autorizuar me anë të specimenëve të nënshkrimeve të vërtetuara nga ai ose ajo, do të përfaqësojnë Marrësin në zbatimin e kësaj marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk do të shfuqizohet derisa revokimi i shprehur i saj nga përfaqësuesi i Marrësit, i autorizuar në atë kohë, të jetë marrë nga KfW.

5.2 Shtesa ose ndryshime ndaj kësaj marrëveshjeje, si edhe çfarëdo njoftimi apo deklarimi që dërgohet nga palët kontraktuese sipas kësaj marrëveshjeje do të jenë me shkrim. Çfarëdo njoftimi apo deklarimi i tillë do të jetë marrë (do të quhet i marrë), pasi ai të ketë mbërritur në adresat vijuese të palës kontraktuese korresponduese ose në atë adresë tjetër në të cilën pala kontraktuese korresponduese i ka njoftuar palës tjetër kontraktuese.

Për KfW: KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany (Republika Federale e Gjermanisë)
Faks: +49 69 7431 2944

Për Marrësin: Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 4
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Faks: + 355 4 222 8494

Neni 6

Shërbimet e ekspertit

6.1 Marrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit:

a) do t'i japë shërbimet e ekspertit për t'u kryer nga këshilltarë të kualifikuar e të pavarur (konsulentët) thelbësisht në përputhje me kuptimin e tyre të rënë dakord ndërmjet Marrësit dhe KfW për shërbimet e ekspertit;

b) në vijim të parazgjedhjes dhe tenderit të hapur (publik) konkurrues ndërkombëtar do t'i japë kontratën Këshilltarit (Konsulentit) të pavarur të kualifikuar. Procedura për dhënien e kësaj kontrate do të rregullohet nga “Udhëzimet për caktimin e këshilltarëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim” (shtojca I), që përbën një pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje;

c) do të sigurojë financimin e plotë të shërbimeve të ekspertit dhe mbi kërkesën e KfW, do t'i sigurojë KfW prova që provojnë se janë mbuluar kostot që nuk janë paguar nga ky kontribut financiar;

d) do të ruajë apo do të bëjë që të ruhen, regjistrat dhe dokumentet që tregojnë në mënyrë të padiskutueshme të gjitha kostot e dala në lidhje me studimin e realizueshmërisë e që identifikojnë qartësisht shërbimet e financuara nga kontributi financiar;

e) do të mundësojë përfaqësuesit e KfW në çdo kohë që të inspektojnë regjistrat dhe dokumentet e shpërmendura, si edhe çdo dokument tjetër e të gjitha dokumentet e tjera me rëndësi për zbatimin e shërbimeve të ekspertit;

f) do t'i sigurojë KfW çfarëdo informacioni dhe të gjitha informacionet dhe raportet mbi shërbimet e ekspertit dhe mbi ecurinë e mëtejshme të tyre, siç mund të kërkohej nga KfW;

g) me nismën e vet, do të informojë menjëherë KfW për cilëndo rrethanë dhe të gjitha rrethanat që pengojnë apo rrezikojnë seriozisht zbatimin e shërbimeve të ekspertit ose qëllimin e tyre;

h) do të japë komente mbi raportet e Këshilltarit (Konsulentit) ose do të njohë përmes miratimit të tij për përmbajtjen duke bashkë nënshkruar raportet; dhe



i) do t'i marrë vendimet e tij mbi të gjitha projektet, raportet, studimet dhe zëvendësimin e anëtarëve të personelit të Këshilltarit (Konsulentit) në marrëveshje me KfW.

6.2 Menjëherë pas përfundimit të shërbimeve të porositura të ekspertit, KfW do t'i sigurohen aq kopje të të gjitha projekteve, raporteve e studimeve të hartuara nga Këshilltari (Konsulenti) sa mund të kërkojë KfW. Kjo e fundit mund të bëjë vlerësimin e këtyre studimeve.

6.3 Marrësi nuk mund të nxjerrë një të drejtë për financimin e projektit të përgatitur nga financimi i vetë studimit të realizueshmërisë. Sidoqoftë, Marrësi do t'i njohë Republikës Federale të Gjermanisë një mundësi për të financuar projektin sipas bashkëpunimit financiar.

Neni 7

Shërbimet e Këshilltarit (Konsulentit)

7.1 Detyrat e Këshilltarit (Konsulentit) do të përfshijnë përgatitjen e studimit të fizibilitetit për ndërtimin e vendgrumbullimit rajonal e sanitar për qarkun e Vlorës në Shqipëri. Termat e referencës për Këshilltarin (Konsulentin) do të bihen dakord ndërmjet Marrësit, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe KfW.

7.2 KfW do të ruajë të drejtën e pakufizuar për të përdorur dhe për të shfrytëzuar rezultatet e shërbimeve të ekspertit dhe të gjitha dokumentet e lidhura me to, të financuara nga ky kontribut financiar, në çdo kohë dhe në të gjitha vendndodhjet sipas zgjedhjes së saj.

Neni 8

Dispozita të ndryshme

8.1 Marrësi do të sigurojë që personat e ngarkuar nga vetë ai, me zbatimin e shërbimeve të ekspertit, me dhënien e çfarëdo kontrate mbi shërbimet e ekspertit, që do të financohen dhe me livrimet e kërkuara të shumave të kontributit financiar, nuk do të kërkojnë, marrin përsipër, paguajnë, japin, premtojnë apo marrin premtime për pagesa të paligjshme ose përparësi të tjera në lidhje me këto detyra.

8.2 Nëse cilado nga dispozitat e kësaj marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten në fuqi. Çfarëdo mangësie që vjen si rrjedhojë e kësaj do të plotësohet me një dispozitë që është në përputhje me qëllimin e kësaj marrëveshjeje.

8.3 Marrësi nuk mund të caktojë apo transferojë, zotojë apo vërë peng çfarëdo pretendimesh nga kjo marrëveshje.

8.4 Kjo marrëveshje do të rregullohet nga legjislacioni i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i arritjes së saj do të jetë Frankfurt am Main. Në rast dyshimi në lidhje me përkthimin e kësaj marrëveshjeje, do të ketë përparësi teksti në anglisht.

8.5 Marrëdhëniet ligjore, të vendosura me anë të kësaj marrëveshjeje ndërmjet KfW dhe Marrësit, do të ndërpriten 6 vjet pas livrimit të fundit.

Bërë në dy kopje origjinale.

Frankfurt am Main

Në datën x të muajit x, 2012

KfW

Tiranë

Në datën x të muajit x, 2012

Ministria e Financave

Shtojca I: "Udhëzimet për caktimin e këshilltarëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim"

<https://www.kfw-entwicklungsbank.de/Download-Center/PDF-Dokumente-Richtlinien/Consulting-E.pdf>

VENDIM
Nr. 604, datë 10.4.2013

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SHITESË TË KONCESIONIT “PËR DISA
NDRYSHIME DHE SHITESA NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”
(NDËRTIM, OPERIM, TRANSFERIM), TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË
EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS DHE BASHKIMIT TË PËRKOHSHËM
TË SHOQËRIVE “TITAN” SHPK DHE “OSMANI” SHPK, PËR NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALEVE “BISHNICA 1” DHE “BISHNICA 2”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4, e 27 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes shtesë të koncesionit “Për disa ndryshime dhe shtesa në kontratën e koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim, transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Titan” sh.p.k. dhe “Osmani” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve “Bishnica 1” dhe “Bishnica 2””, të miratuar me vendimin nr. 1395, datë 17.10.2008 të Këshillit të Ministrave.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE SHITESË KONCESIONI

**PËR DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E KONCESIONIT TË FORMËS “BOT”, TË
LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS DHE
BASHKIMIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRIVE “TITAN” SHPK DHE “OSMANI” SHPK,
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE “BISHNICA 1” DHE “BISHNICA 2”**

Në Tiranë, më datë 1, muaji prill, viti 2013 (dy mijë e trembëdhjetë), para meje noter Gj. Kongoli, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, me adresë: “Kont Urani” nr. 3, u paraqitën palët kontraktuese si më poshtë:

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që më poshtë do të quhet “Autoritet kontraktues”, përcaktuar si i tillë me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 214, datë 21.2.2008 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Bishnica 2”, dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë”, përfaqësuar nga z. Edmond Haxhinasto, i datëlindjes 16.11.1966, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga letërnjoftimi nr. 027849998; dhe

Bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Titan” sh.p.k. dhe “Osmani” sh.p.k., që në vijim do të quhet “Koncesionari”, i formuar sipas marrëveshjes nr. 1547 Kol, nr. 1732 Rep, datë 8.5.2008, me këto të dhëna:

Shoqëria “Titan” sh.p.k., me seli në Tiranë, regjistruar në QKR, datë 6.9.2007, me NIPT K72111004T.



Shoqëria “Osmani” sh.p.k., me seli në Gramsh, regjistruar si person juridik me vendimin nr. 16471, datë 12.12.1996 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, NIPT: J76314808M.

Shoqëria “Titan” sh.p.k. është caktuar si përfaqësuese me kompetenca të plota për bashkimin e shoqërive, me anë të kontratës nr. 1732 Rep, nr. 1547 Kol, datë 8.5.2008 “Për bashkëpunim të përkohshëm të shoqërive” dhe përfaqësohet nga z. Refat Mustafaraj, i biri i Zakos, lindur më 4.10.1957 në Vlorë, banues në Tiranë, Rruga e Barrikadave, për identitetin e të cilit u sigurova nga pasaporta nr. Z0940672, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Palët me vullnetin e tyre të lirë, bien dakord si më poshtë:

Të lidhin këtë marrëveshje shtesë koncesioni, si pjesë përbërëse e kontratës së koncesionit të formës BOT, të nënshkruar nga palët datë 6 tetor 2008, me nr. 4579 Rep, nr. 3416 Kol, e lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Titan” sh.p.k. dhe “Osmani” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Bishnica 1” dhe “Bishnica 2”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1395, datë 17.10.2008.

Hyrje

Duke pasur parasysh që:

- Gjatë procesit të marrjes së lejeve, shoqëria koncesionare “Bishnica 1, 2” sh.p.k., nuk ka mundur të sigurojë lejenë e ndërtimit për hidrocentralin “Bishnica 1”, me gjithë mbështetjen e autoritetit kontraktues, për arsye se:

- Kryetari i komunës Velcan, banorët e fshatit dhe kryeplaku, me shkresën nr. 50 prot. datë 17.4.2009 nuk lejojnë ndërtimin e këtij hidrocentrali, pasi ky hidrocentral shërben për vaditje, derdhjen e ujërave të zeza, si dhe ndërtimi i tij ka pasoja ekologjike në zonë dhe komunitet;

- Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Shkumbin-Devoll, me vendimin nr. 5, datë 29.5.2012 ka vendosur “Anulim leje të përdorimit të ujit HEC “Bishnica nr. 1”, i cili vërteton se ndërtimi i këtij HEC-i dëmton ekologjikisht zonën dhe komunitetin;

Palët bien dakord që në kontratën bazë të koncesionit nr. 4579 Rep dhe 3416 Kol datë 6.10.2008, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1395, datë 17.10.2008 të bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në kontratën bazë të koncesionit nr. 4579 Rep dhe 3416 Kol datë 6.10.2008, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1395, datë 17.10.2008:

Të hiqet termi “hidrocentrali “Bishnica 1”” kudo ku është shprehur.

Fjalët “hidrocentralet/eve” të zëvendësohen me fjalën “hidrocentrali/t”.

Kudo ku është shprehur “... sipas aneksit 1/aneksit 2, bashkëlidhur kontratës” zëvendësohet me “... sipas aneksit 1 bashkëlidhur marrëveshjes shtesë”.

Neni 2

Në nenin 1 “Përkufizime dhe interpretime”

Në pikën 1.5, fjalët: “...Hidrocentralet “Bishnica 1” dhe “Bishnica 2” me vendndodhje në Pogradec, me fuqi totale të instaluar 2 950 kW dhe prodhim total të energjisë elektrike rreth 12 910 000 kWh” zëvendësohen me fjalët “Bishnica 2” me vendndodhje në Pogradec me fuqi totale të instaluar 2 500 kW dhe prodhim total të energjisë elektrike rreth 11 120 000 kWh”.

Neni 3

Neni 3 ndryshon si më poshtë:

“Karakteristikat e hidrocentralit “Bishnica 2”

Hidrocentrali “Bishnica 2” do të ndërtohet në rrjedhën e përroit të Bishnicës në rrethin e

Pogradecit, me këto karakteristika:

HEC-i “Bishnica 2”

- Kuotat e veprave

○ Kuota e veprës së marrjes 1 030 m.m.n.d.

○ Kuota e godinës së centralit 665 m.m.n.d.

- Prurja llogaritëse 0.85 m³/s

- Fuqia e instaluar 2 500 kW

- Prodhimi i energjisë elektrike 11 120 000 kWh

Neni 4

Në nenin 8 “Detyrimet e koncesionarit”

Paragrafi sipas pikës 4 zëvendësohet me paragrafin: “Të zbatohet punimet dhe planin e investimit sipas aneksit 1 bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje shtesë”.

Paragrafi sipas pikës 6 zëvendësohet me paragrafin: “Të zbatohet projektin për ndërtimin e hidrocentralit “Bishnica 2” me fuqi të vendosur jo më pak se 2500 kW”.

Neni 5

Në nenin 9 “Vlerësimi i investimeve” përbajtja e tij ndryshon si më poshtë:

“Mbi bazën e të dhënave të aneksit 1, investimet që do të kryhen nga koncesionari për hidrocentralin “Bishnica 2” janë në vlerën totale prej 208,000,000 (dyqind e tetë milionë), të ndara sipas aneksit 1 bashkëlidhur kësaj marrëveshjeje”.

Neni 6

Në nenin 23 “Sanksionet”

Në pikën 23.2, fjalët: “... të prodhimit të energjisë elektrike prej 12 910 000 kWh/vit” zëvendësohen me fjalët “... të prodhimit të energjisë elektrike prej 11 120 000 kWh/vit”.

Neni 7

Palët nuk kanë dhe nuk do të kenë asnjë pretendim në lidhje me moszbatimin e projektit “Bishnica 1”, pasi ky moszbatim ka ardhur për arsye që nuk varen nga palët kontraktuese.

Neni 8

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, sipas ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar.

Nenet e tjera të kontratës bazë nuk kanë ndryshim.

Marrëveshja hartohet në 6 (gjashtë) kopje dhe nënshkruhet pa vërejtje nga të dyja palët.

AUTORITETI KONTRAKTUES
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS
PËRFAQËSUAR NGA
Edmond Haxhinasto

KONCESIONARI
BASHKIMI I PËRKOHSHËM I SHOQËRIVE
“TITAN” SHPK. DHE “OSMANI” SHPK
PËRFAQËSUAR NGA
Refat Mustafaraj



VENDIM

Nr. 605, datë 24.7.2013

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE,
QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT
“DRIZA 1”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Driza 1”, që i jepet shoqërisë “Gerti Metal” sh.p.k.

2. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Driza 1”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr. 606, datë 24.7.2013

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE,
QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT
“VILIQ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Viliq”, që i jepet shoqërisë “Ergi konstruktion” sh.p.k.

2. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Viliq”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM
Nr. 607, datë 24.7.2013

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE,
QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT
“KOLOSJAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Kolosjan”, që i jepet shoqërisë “2S 2012” sh.p.k.

2. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Kolosjan”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 608, datë 24.7.2013

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE,
QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT
“KALIVAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Kalivar”, që i jepet shoqërisë “BE-IS” sh.p.k.

2. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Kalivar”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM

Nr. 609, datë 24.7.2013

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE,
QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT
“PLEPI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Plepi”, që i jepet shoqërisë “Neron Tec” sh.p.k.

2. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Plepi”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

VENDIM

Nr. 612, datë 24.7.2013

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE,
QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT
“ZALL XHUXHE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Zall Xhuxhe”, që i jepet shoqërisë “Gloris Construction” sh.p.k.

2. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Zall Xhuxhe”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

VENDIM
Nr. 622, datë 24.7.2013

**PËR MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE,
QË I JEPET SHOQËRISË PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT
“GJADËR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën për zgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Gjadër”, që u jepet shoqërive “Rafaelo 2002” sh.p.k. dhe “S.P.E Energy” sh.p.k.

2. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën për zgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Gjadër”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 630, datë 31.7.2013

**PËR LEJIMIN E ZYRËS SË ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT GJYQËSOR PËR
KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK PËR DISA PROJEKTE TË
SISTEMIT GJYQËSOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013” dhe në vijim të vendimit nr. 591, datë 10.7.2013 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2013”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor për kryerjen e procedurave të prokurimit publik me fondet e miratuar në buxhetin e këtij viti, përkatësisht për:

- a) “Blerje pajisjesh dhe mobilesh për Gjykatën e Lartë”;
- b) “Blerje pajisjesh elektronike për Gjykatën e Lartë”;
- c) “Blerje automjeti për Gjykatën e Lartë”;
- ç) “Rikonstruksion i tualeteve të Gjykatës së Lartë”;
- d) “Blerje pajisjesh, mobilesh zyre për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”;
- dh) “Mirëmbajtje e godinës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (godina civile dhe penale)”;



- e) “Blerje pajisjesh elektronike për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”;
- ë) “Blerje pajisjesh për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë”;
- f) “Blerje pajisjesh elektronike për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës”;
- g) “Blerje pajisjesh elektronike për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër”;
- gj) “Blerje raftesh arkivi për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr. 15, datë 12.7.2013

**PËR PROCEDURAT E POSAÇME PËR SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LICENCË TË
INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE DHE INSTITUCIONEVE ARSIMORE
PLOTËSUESE PRIVATE PARAUNIVERSITARE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 15, 16, pika 4, neni 17 pika 3/d dhe neni 20 të ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

KREU I
KËRKESA PËR DHËNIEN E LICENCËS

1. Kërkesa dhe dosja e aplikuesit për licencë, e plotësuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë udhëzim paraqiten në Qendrën Kombëtare të Licencimit (QKL) jo më vonë se 3 muaj para fillimit të vitit shkollor për institucionet arsimore dhe gjatë vitit për institucionet arsimore parashkollore dhe ato plotësuese parauniversitare private.

2. Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesës bëhet në përputhje me kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese shoqëruese përkatëse, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

3. Qendra Kombëtare e Licencimit dërgon në formë elektronike në Drejtorinë për Zhvillimin e Arsimit Jopublik (DZHAI) në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës (MASH), dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi. DZHAI shqyrton paraprakisht dokumentacionin e subjektit (person juridik ose fizik) që aplikon për licencë të institucionit arsimor parauniversitar privat apo të institucionit arsimor plotësues parauniversitar privat. Në rast se gjatë shqyrtimit paraprak, DZHAI konstaton mangësi në dokumentacion, i propozon Ministrit të Arsimit dhe Shkencës refuzimin e kërkesës.

4. Dosja e subjektit aplikues duhet të përmbajë dokumentacionin për:
- a) Marrëdhënien pronësore (certifikatë pronësie, kontratë qiraje etj.) që subjekti ka për objektin/et dhe mjedisin/et që do të përdoren për shërbimin arsimor;
 - b) Arsimimin dhe kualifikimin sipas akteve ligjore dhe nënligjore të drejtuesit didaktik dhe personelit mësimdhënës;
 - c) Kontratën e punës me kohë të plotë mes subjektit kërkues dhe drejtuesit didaktik;
 - d) Rregulloren e brendshme të institucionit, të detajuar, në të cilën, ndër të tjera, të përcaktohet:
 - d.1 Lloji dhe niveli i arsimimit që do të ofrojë numrin e grupeve apo të klasave që do të formohen, numrin maksimal të fëmijëve/nxënësve për grup/klasë dhe, për shkollat, titullin e dokumentit që do të lëshohet në përfundim të çdo viti shkollor, ciklit apo kursit të arsimimit.
 - d.2 Emërtimi i institucionit, numrin e telefonit personal të administratorit dhe të institucionit, adresën e institucionit dhe të postës elektronike.
 - d.3 Deklaratë dhe listë e detajuar për shërbimet që do të ofrohen në këtë institucion.
 - d.4 Tarifat përkatëse dhe modalitetet e pagesave që do të kontraktohen me përfuturit e shërbimit.
 - e) Deklaratë nga subjekti për zbatimin e kurrikulës zyrtare (plane mësimore, programe lëndore dhe tekste mësimore) të miratuara nga MASH-i.
 - f) Listë të plotë të stafit drejtues, mësimdhënës dhe të dhënat mbi arsimimin përkatës të stafit, si dhe ngarkesën mësimore të tij.
 - g) Deklaratë për inventarin faktik të bazës materiale dhe asaj didaktike që mendohet të vihet në dispozicion dhe që është në funksion të arsimimit, edukimit dhe realizimit të kërkesave të programeve lëndore (për të provuar se mjetet mësimore janë të mjaftueshme për të realizuar kërkesat e planit mësimor dhe të programeve lëndore).
5. Standardet normative që duhet të përmbushë/in objekti/et që do të funksionojë/në si institucion/e arsimore private janë:
- a) Klasë e zakonshme konsiderohet ai mjedis mësimor që ka një normativë sipërfaqeje shfrytëzimi prej 1.3-1.6 m²/nxënës;
 - b) Nyjat hidrosanitare përfshijnë 1 boks për 40 djem, 1 boks për 30 vajza, si dhe 1 boks për administratën.
 - c) Për kopshtet, shërbimet higjienike vendosen pranë çdo grupi dhe pozicionohen në mënyrë të tillë që të jenë sa më afër për secilin grup. Numri i bokseve duhet të jetë 3 (tri) për një grup, të ndarë me mure nga njëri-tjetri, si dhe duhet të ketë dhe katër lavamanë me ujë të pijshëm. Banjat duhet të kenë porta të hapshme nga jashtë dhe të shkëputura nga dyshemeja. Pajisjet e banjave duhet të jenë të përshtatshme për moshën e fëmijëve.
 - d) Për edukimin fizik, subjekti që kërkon licencë duhet të ketë në dispozicion një palestër sportive (për shkollat nën 100 nxënës shfrytëzohet një klasë në katin përdhe me përmasa 60 m²) dhe një kënd sportiv jo më i vogël se 100 m².
 - e) Objektet arsimore që vihen në dispozicion për nivele të ndryshme arsimimi (kopshte, shkollë 9-vjeçare dhe shkollë e mesme) të kenë mjedise që nuk komunikojnë me njëri-tjetrin.
 - f) Lidhur me normativën e ndriçimit natyral duhet që sipërfaqja e dritareve të mbulojë minimalisht 15% të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi duhet të jetë në krahun e majtë të nxënësit, mundësisht i orientuar nga juglindja. Ndriçimi të realizohet me dritare me xham të tejdukshëm. Dritaret nuk lejohet të vendosen në murin ku është vendosur dërrasa e zezë.
 - g) Për shkollat e arsimit bazë (sistemi 9-vjeçar) duhet të jenë në dispozicion, minimumi 9 klasa për ciklin e ulët dhe të lartë dhe dy dhoma mësuesish. Për shkollat e ciklit të ulët (6-vjeçar) duhet të jenë në dispozicion, minimumi 6 klasa dhe një dhomë mësuesish. Për shkollat e mesme të përgjithshme/profesionale duhet të jenë në dispozicion, minimumi, 5 dhoma mësimore. Për kopshtet të ketë minimalisht 3 dhoma mësimore.



h) Objektet arsimore me mbi 200 nxënës duhet të jenë të pajisura me dalje dhe shkallë emergjence.

i) Objektet arsimore duhet të jenë të pajisura me pikën e ndihmës së shpejtë dhe pajisjet e nevojshme në të.

j) Objektet arsimore duhet të kenë sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit.

k) Objektet arsimore të jenë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore dhe të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për nxënësit, duke shmangur elementet e rrezikshmërisë. Materialet e përdorura për ndërtimin e tyre nuk duhet të kenë elemente përbërëse të dëmshme për shëndetin e nxënësve. Këto materiale duhet të sigurojnë akustikë të mirë në mjedisin e mësimit dhe të jenë izoluese ndaj zhurmave dhe luhatjeve të temperaturës.

l) Objektet arsimore duhet të jenë larg zonave industriale, varrezave apo zonave me ndotje mbi normat e lejuara.

m) Objektet arsimore të kenë sistem ngrohjeje dhe burime alternative për furnizimin me ujë dhe energji elektrike.

6. Verifikimi i përmbushjes së standardeve normative të infrastrukturës të objektit shkollor kryhet me nismën e Drejtorisë për Zhvillimin e Arsimit Jopublik (DZHAI) nga personeli i kualifikuar i njësisë arsimore vendore (NJAV) në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e subjektit. NJAV përgatit një raport vlerësimi shoqëruar me rekomandime për miratimin apo jo të licencës.

7. DZHAI, pasi vlerëson rregullsinë e dokumentacionit dhe përputhshmërinë e planit mësimor, programeve lëndore dhe teksteve mësimore që do të zbatojë institucioni, me ato të miratuara, vendos miratimin ose refuzimin e kërkesës për licencë.

7.1 Vendimi miratues ose refuzues i MASH-it i dërgohet QKL-së në formë elektronike dhe shkresore. Për rastet kur kërkesa e subjektit nuk miratohet, vendimi refuzues duhet të përcaktojë qartë shkaqet e refuzimit, të shprehura në mënyrë të tillë që kërkuesi të kuptojë se ç'masa duhet të marrë që, me një aplikim të dytë, të mund të pajiset me licencën e kërkuar.

7.2 Vendimi i miratimit apo refuzimit, që i përcillet QKL-së, publikohet në Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Licencave, sipas procedurave dhe afateve ligjore të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", i ndryshuar".

8. Mosdërgimi i vendimit brenda afatit (2 javë), vlerësohet si miratim në heshtje, përveç rastit kur, para mbarimit të këtij afati, DZHAI kërkon në regjistrin aplikativ, shtyrje afati për rastin përkatës. Shtyrja e pashpallur në regjistrin aplikativ është e pavlefshme. Kërkesa për shtyrje të afatit sqaron domosdoshmërisht edhe shkaqet objektive të pamundësisë për shqyrtimin e kërkesës që e kanë diktuar atë. Shtyrja mund të përdoret vetëm një herë dhe ajo nuk mund të jetë më e gjatë se vetë afati përkatës i marrjes së vendimit.

9. Institucioni arsimor e ndërpret veprimtarinë e tij arsimore vetëm në fund të vitit shkollor.

10. Pas procedurave të revokimit të veprimtarisë së tij pranë QKL-së, institucioni duhet të lajmërojë menjëherë Njësinë Arsimore Vendore (NJAV) dhe të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e plotë në NJAV.

KREU II TARIFAT E SHËRBIMIT

1. Institucionet arsimore private parauniversitare dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare licencohen përkundrejt tarifave të përcaktuara si më poshtë:

Nr.	Institucionet	Tarifa në lekë
1	Për kopsht	35.000 (tridhjetë e pesë mijë)
2	Për shkollë të ciklit të ulët fillor	45.000 (dyzet e pesë mijë)
3	Për shkollë të ciklit të lartë 9-vjeçar	45.000 (dyzet e pesë mijë)
4	Për shkollë 9-vjeçare	55.000 (pesëdhjetë e pesë mijë)
5	Për shkollë të mesme të përgjithshme	70.000 (shtatëdhjetë mijë)
6	Për shkollë të mesme teknike-profesionale e social-kulturore	60.000 (gjashtëdhjetë mijë)
7	Për kurs plotësues (IAPPRP)	70.000 (shtatëdhjetë mijë)

KREU III

DETYRIMET E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT PARAUNIVERSITAR DHE INSTITUCIONIT ARSIMOR PLOTËSUES PRIVAT PARAUNIVERSITAR

1. Një institucion arsimor parauniversitar privat apo institucion arsimor plotësues parauniversitar privat me fillimin dhe gjatë veprimtarisë së tij duhet të raportojë në NJAV sipas afateve të përcaktuara prej saj:

- numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve që do të fillojnë dhe mbarojnë vitin shkollor sipas udhëzimeve të MASH-it dhe statistikave tip të miratuara nga INSTAT-i;
- planin mësimor, programet lëndore dhe strukturën që do të ketë institucioni në fillim të çdo viti shkollor;
- certifikatën e regjistrimit në organin tatimor;
- listën e veprimtarive jashtëshkollore që janë parashikuar të zhvillohen gjatë vitit shkollor (për institucionin arsimor privat parauniversitar).

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat duhet të miratojë në MASH çdo ndryshim në planin mësimor, programet lëndore apo tekstet që do të përdorë institucioni dhe çdo projekt apo eksperimentim psiko-pedagogjiko-didaktik që kërkon të kryejë sipas rastit.

3. Ndryshimet në vendndodhje dhe në infrastrukturën e godinës që mund të pësojë institucioni arsimor privat i licencuar, shqyrtohen dhe miratohen nga QKL-ja, pas miratimit të Drejtorisë për Zhvillimin e Arsimit Jopublik (DZHAI), 3 muaj para fillimit të vitit shkollor përkatës.

4. Një institucion arsimor privat parauniversitar apo institucion arsimor plotësues privat parauniversitar duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) dokumentacionin themeltar në ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, regjistër të veçantë, statistika vjetore të numrit të nxënësve dhe të mësuesve;
- b) regjistra të përkohshëm, si: regjistra klase, evidencë për lëvizjen e nxënësve (i detyrueshëm për institucionin arsimor privat parauniversitar), planet mësimore dhe programet lëndore të zbatuara çdo vit shkollor;
- c) rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit;
- d) kriteret për pranimin e nxënësve dhe të mësuesve;
- e) kontratat me prindërit për shërbimet arsimore apo shërbime të tjera jashtëshkollore që ofron;
- f) kontratat e punës me mësuesit (për ata me kohë të plotë apo të pjesshme).

Ky dokumentacion, në rast inspektimi e monitorimi të veprimtarisë së institucionit, duhet t'u vihet në dispozicion organeve kompetente mbikëqyrëse.

5. Institucionet arsimore private, të cilat funksionojnë sipas kriterëve të përcaktuara me këtë udhëzim, veprojnë në përputhje me detyrimet e institucioneve arsimore dhe dispozitat normative që rrjedhin nga ligji nr. 69/2012, datë 21.6.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".



6. Në rast të revokimit të veprimtarisë së tij nga QKL-ja, institucioni duhet të lajmërojë menjëherë Njësinë Arsimore Vendore (NJAV) dhe të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e plotë në NJAV.

7. Moszbatimi apo mosrespektimi i këtyre detyrimeve, si dhe mosdhënia apo fshehja e informacioneve nga organet kompetente mbikëqyrëse dhe inspektuese, të cilat do të verifikojnë apo kontrollojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e këtyre institucioneve arsimore, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës nr. 33, datë 1.11.2010 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes së funksionimit për institucionet arsimore private dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare”, shfuqizohet.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria për Zhvillimin e Arsimit Jopublik, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme (sektori juridik) dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR Nr. 296, datë 18.7.2013

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Mbështetur në nenin 102 pika 4 të Kushtetutës dhe në nenet 27, 29, 31 dhe 32 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. T’i delegohet Drejtorit të Shërbimeve të Përgjithshme të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës z. Hektor Buza, kompetenca për nënshkrimin e shkresave dhe akteve nënligjore të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës gjatë mungesës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, duke filluar nga data 19.7.2013 deri në datën 26.7.2013, me përjashtim të akteve që lidhen me rialokimin dhe çeljen e fondeve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

2. Ky urdhër të dërgohet pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare për botim në Fletoren Zyrtare.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i Shërbimeve të Përgjithshme të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, me vendimin nr. 140, datë 18.6.2013 vendosi vërtetimin e faktit juridik të lindjes dhe të vdekjes së shtetasit (Aristir Gjeko) Aristidh Gjoka.

KËRKESË

Shtetasja Majlinda Haliti, e bija e Ahmetit dhe Lidës, me datëlindje 13.5.1966, lindur dhe banuese në lagjen “Çlirimi”, Lushnjë, kërkon shpalljen të zhdukur të vëllait të saj, shtetasit Artur Daja.

KËRKUESE
Majlinda Haliti

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 2.8.2013
Doli nga shtypi më 2.8.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 25 lekë